



Tiranë, më    /    2016

## RREGULLORE

### PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIONIT TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL"

DHE

### "MASTER SHKENCOR/MASTER I ARTEVE TË BUKURA" NË FAKULTETIN E MUZIKËS, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE PËR VITIN AKADEMIK 2016 – 2017

MIRATUAR ME VENDIM NR   11  , DATË   15.02.2016  

TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE



Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 76 Pranimi në programet e ciklin e dytë të studimeve, si dhe mbështetur në Rregulloren e UART të ciklit të dytë të studimeve "Master" Kreu II "Dokumentimi themelor i programeve të studimit në Master" Neni 10 "Pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë", konkurset e pranimit në Fakultetin e Muzikës për vitin akademik 2016-2017 do të zhvillohen si më poshtë:

### Neni 1

#### Pranimi i kandidatëve

- 1.1 Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Arteve, bëhen mbi rezultatit të konkurseve që zhvillohen për studimet në ciklin e dytë të studimeve "Master", pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit sipas kësaj rregulloreje si dhe kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 1.2 Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta "Për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja", do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3 Përzgjedhja e tyre është e ndërvarur nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, posaçërisht për trojet Shqiptare.

### Neni 2

#### Kriteret e pranimit

- 2.1 Të kenë kryer programin e studimit të ciklit të parë Bachelor pranë këtij fakulteti ose nga Fakultete të tjera analoge si brenda dhe jashtë vendit.
- 2.2 Pranohen të gjithë ato kandidatë që kanë kryer studimet në ciklin e vjetër 4-vjeçar në fakultetin e Muzikës. Gjithashtu edhe ato kandidatë të ciklit 4-vjeçar, të fakulteteve të tjera analoge brenda dhe jashtë vendit.
- 2.3 Për konkurrentët që kanë kryer studime jashtë vendit kërkohet njësimi i Diplomës sipas Ligjeve në fuqi.
- 2.4 Baza e konkurrimit për kandidatët në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Muzikës për studime në ciklin e dytë të studimeve "Master", janë kriteret e miratuara nga Senati Akademik i universitetit të Arteve.
- 2.5 Kandidatët për programin e studimit Master Profesional dhe Master Shkencor/Master i Arteve të Bukura, duhet të dorëzojnë pranë Fakultetit të Muzikës, dosjen personale të konkurrentit ku të jenë të përfshira:

- I. CV e tij/e saj,
- II. Diploma,
- III. Listën e notave të programit të studimit të kryer,



- IV. Dëshmi mbi rezultatet e arritura në procesin e realizimit të programit mësimor,
- V. Projekte,
- VI. Koncerte,
- VII. Pjesëmarrje të ndryshme, etj.

2.6 Dosja duhet të përmbajë dëshmitë e aktiviteteve artistike, si brenda dhe jashtë UART apo IAL-ve të tjera analoge:

- I. Postera,
- II. Fletë palosje,
- III. Fotografi,
- IV. Dhe çdo material tjetër që dëshmon aktivitetet artistike të konkurrentit.

### Neni 3

#### Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

- 3.1 Dekani i Fakultetit, mbështetur nga propozimet e Përgjegjësve të Njësive Bazë, merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Pranimi për çdo program e Studimi.
- 3.2 Përbërja e Komisionit të Pranimi të Programit të Studimit shpallet në ditën e fillimit të konkursit.
- 3.3 Në përbërjen të Komisionit të Pranimi aktivizohen:
  - I. Titullarë të fushës përkatëse,
  - II. Pedagogë efektivë të Departamenteve përkatëse,
  - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës për ato programe studimi ku nuk mund të mbulohen nga pikat I, II të këtij Neni.
- 3.4 Në përbërjen të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë bërë konsultime private lidhur me konkursin e pranimit apo janë në konflikt interesi.
- 3.5 Në mjediset ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga titullari i Fakultetit të Muzikës .
- 3.6 Për monitorimin e të gjithë procedurave të konkurrimit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, Rektori i UART, me Urdhër të posaçëm ngre grupin përkatës, i cili monitoron cilësinë e zhvillimit të gjithë procedurave të konkurrimit në Fakultetin e Muzikës, si dhe nga përfaqësuesit e MAS.

### Neni 4

#### Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurrimit.

- 4.1 Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurs të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e Nenit 2, të kësaj rregulloreje.
- 4.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët që janë regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Muzikës, brenda afatit të përcaktuar nga MAS.



- 4.3 Konkursi për Fakultetin e Muzikës do të zhvillohet në mjediset e Fakultetit, sipas udhëzimeve të MAS.
- 4.4 Lejohen të hyjnë në konkurs vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurrim, të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi si më poshtë:
  - I. *Kartë Identiteti,*
  - II. *Pasaportë për jashtë shteti,*
  - III. *Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente identifikimi nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.*
- 4.5 Kandidati konkurrent për të hyrë në konkurs duhet të ketë bërë pagesën e përcaktuar, në llogari të Universitetit të Arteve. Kjo e bazuar në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- 4.6 Në varësi të specifikave për secilin Program Studimi, komisionet do të punojnë paradite dhe pasdite, duke i bërë të ditura më parë oraret përkatëse. Oraret duhet të shpallen në mjediset e Fakultetit të Muzikës
- 4.7 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe mjediset e zhvillimit të tyre do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve në mjediset e Fakultetit të Muzikës.
- 4.8 Kalendarin e Orareve dhe Mjedisëve shpallet në Fakultet një javë përpara fillimit të konkursit.
- 4.9 Ditën e parë të konkursit, pasi të jenë sistemuar në mjediset e zhvillimit të konkursit, kandidatëve u komunikohen rregullat e konkurrimit. Kjo bëhet nga Kryetarët e Komisioneve përkatëse.
- 4.10 Sekretaria mësimore ua dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të Programit të Studimit të gjitha materialet për konkurs, si dhe listat e konkurrentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 4.11 Bazuar në kriteret për secilin Program Studimi, komisionet krijojnë hapësirën kohore të nevojshme për zhvillimin e konkursit.

#### Neni 5

#### Mënyra e Vlerësimit

- 5.1 Vlerësimi maksimal për çdo konkurrent është gjithsej **100 pikë**.
- 5.2 Ndarja e pikëve të vlerësimit sipas zërave të përcaktuara në Kriteret e Konkurrimit për çdo program studimi, bëhet me Vendim *ad hoc* të Komisionit të Vlerësimit.

#### Neni 6

#### Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

- 6.1 Vlerësimi për çdo kandidat bëhet nga Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohen nga titullari i Fakultetit.
- 6.2 Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre).



- 6.3 Mbas mbarimit të konkurrimit, Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, nën drejtimin e Kryetarit, bën vlerësimin e kandidatëve. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 6.4 100 pikët e mundshme në dispozicion të Komisionit të pranimit, shpërndahen në mënyrë të barabartë tek të gjithë anëtarët e komisionit.
- 6.5 Secili anëtar i komisionit të pranimit vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatit.
- 6.6 Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët përkatëse në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista në fund nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit.
- 6.7 Lista e nënshkruar si dhe shënimet e anëtarëve të komisionit të pranimit për çdo konkurrent, i dorëzohen me procesverbal titullarit të Fakultetit.
- 6.8 Komisionet e Pranimit të Programit të Studimit pas vlerësimeve për çdo kandidat, të gjitha dosjet ia dorëzojnë me procesverbal Titullarit të Fakultetit.
- 6.9 Lista përfundimtare me pikët përkatëse për të gjithë Programet e Studimit firmosen nga Titullari i Fakultetit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

#### Neni 7

##### Shpallja e fituesve

- 7.1 Shpalljen përfundimtare për fituesve e bën Dekani i Fakultetit mbi bazën e kuotave të aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit .
- 7.2 Në rastin kur disa konkurrues kanë fituar të njëjtin numër pikësh, ata nënrenditen midis tyre sipas rendit zbritës të pikëve të fituara.

#### Neni 8

##### Regjistrimi për të fituar statusin e studentit

- 8.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të regjistrohen për të fituar statusin e studentit.
- 8.2 Kandidatët që regjistrohen si student në Universitetin e Arteve duhet të paraqesin **dokumente origjinale**.
- 8.3 Ato duhet të jenë:
  - I. Diploma Bachelor
  - II. Për kandidatët shqiptarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dokumentet e mësipërme duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe e të noteruara.
  - III. Kartë identiteti,
  - IV. Pasaportë,
  - V. 2 ( dy ) fotografi
  - VI. Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit që caktohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.



- 8.4 Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet: numri i regjistrimit, emri i kandidatit si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 8.5 Gjithashtu në këtë regjistër duhet të nënshkruajë çdo kandidat fitues, i regjistruar më parë, por që kërkon të ç'regjistrohet nga kjo degë për arsye të ndryshme.
- 8.6 Kandidatit që ç'regjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale por jo pagesa e regjistrimit.
- 8.7 Regjistrimet e kandidatëve fitues për të gjitha kuotat kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Muzikës, në datat që do të përcaktojë Ministria e Arsimit dhe Sportit.



Prof. Dr. Zana Shuteriqi Prela



Nr. Prot. ... <sup>30</sup>

Tiranë, më 05.02 2016

## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 1. Programi i studimit: **Master i Shkencave në Muzikologji**

Konkursi për studimet e Ciklit II në programin mësimor Master i Shkencave në Muzikologji (Cikli II) zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I
2. Mesatarja e ponderuar e notave të Ciklit I, në lëndët:
  - a. Muzikologji (nota e tre viteve, plus nota e Diplomës)
  - b. Harmoni (Pjesa I, Harmonia shek. XX, Harmoni stilistike)
  - c. Kontrapunkt (Stil i ngushtë, Stil i lirë)
  - d. Instrumentacion
  - e. Orkestracion
  - f. Analizë e formave muzikore
  - g. Histori Muzike.



Mesatarja e notës në pikat 1 dhe 2 duhet të jetë përmbi 8 (tetë)

3. Veprimtaria artistike e kandidatit gjatë periudhës së studimeve të Ciklit I.
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga Komisioni i Vlerësimit ad hoc.

**DEKANI**  
**Prof. Dr. Zana Shuteriqi Prela**







## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 2. Programet e studimit: **Master i Arteve në Kompozim dhe Master i Arteve në Dirigjim**

Konkursi për studimet e Ciklit II në programet e studimit Master i Arteve në Kompozim dhe Master i Arteve të Mukura në Dirigjim, zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I
2. Mesatarja e ponderuar e notave të Ciklit I, në lëndët:
  - a. Kompozicion/Dirigjim (nota e tre viteve, plus nota e Diplomës)
  - b. Harmoni (Pjesa I, Harmonia shek. XX, Harmoni stilistike)
  - c. Kontrapunkt (Stil i ngushtë, Stil i lirë)
  - d. Instrumentacion
  - e. Orkestracion
  - f. Analizë e formave muzikore
  - g. Histori Muzike.

Mesatarja e notës në pikat 1 dhe 2 duhet të jetë përmbi 8 (tetë)



Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 596, www.uart.edu.al

3. Veprimtaria artistike individuale e kandidatit gjatë periudhës së studimeve të Ciklit I.
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga Komisioni i Vlerësimit ad hoc.

**DEKANI**  
**Prof. Dr. Zana Shuteriqi Prela**





## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 3. Programi i studimit: Master Profesional në Pedagogji Muzikore

#### A. Dispozita të përgjithëshme

1. Konkursi për studimet Master Profesional (Ciklit II) në programin Pedagogji Muzikore zhvillohet në dy faza.

#### B. Faza e parë

1. Kjo fazë përfshin shqyrtimin e dosjes së kandidatëve dhe rezultateve të tyre në programin e studimit përkatës të Ciklit I të studimeve.

#### C. Faza e Dytë

1. Faza e dytë përfshin një test integral formimi (profesional dhe të përgjithshëm) të modelit si më poshtë:

Simfonia e parë shqiptare është kompozuar nga:	Klod Debysi është kompozitor:	
	Po	Jo
a. Tish Daija	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Çesk Zadeja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Tonin Harapi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2. Koha në dispozicion për të kryer testin me shkrim është 2 (dy) orë.

3. Kërkesat për hartimin e testit integral të formimit (profesional dhe të përgjithshëm) mbështeten në syllabuset përkatëse të programit të studimit Pedagogji Muzikore të Ciklit I të studimeve.

**DEKANI**  
**Prof. Dr. Zana Shuteriqi Prel**





## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 4. Programet e studimit: Master i Arteve në Violinë, Violë, Violonçel, Kontrabas

Konkursi për studimet e Ciklit II në Programet e studimit Master i Arteve në Violinë, Violë, Violonçel, Kontrabas (Cikli II) zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I, duhet të jetë përmbi 7 (shtatë)
2. Mesatarja e Diplomës, duhet të jetë përmbi 8 (tetë)
3. Aktiviteti artistik individual (solistik, muzikë dhome) i kandidatit gjatë periudhës së studimeve në Ciklit I.
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga Komisioni i Vlerësimit ad hoc.

**DEKANI**

**Prof. Dr. Zana Shuteriqi Prela**





## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 4. Programi i studimit: Master i Arteve në Piano

Konkursi për studimet e Ciklit II në Programin e studimit Master i Arteve në Piano (Cikli II) zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I, duhet të jetë përmbl 7 (shtatë)
2. Mesatarja e Diplomës, duhet të jetë përmbl 8 (tetë)
3. Aktiviteti artistik individual (solistik, muzikë dhome) i kandidatit gjatë periudhës së studimeve në Ciklit I.
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga Komisioni i Vlerësimit ad hoc.

**DEKANI**  
**Prof. Dr. Zana Shuteriqi Prela**





## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimet në programet e studimit të Ciklit II në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 4. Programi i Studimit: Master i Arteve në Kanto

Konkursi për studimet e Ciklit II në Programin e studimit Master i Arteve në Kanto (Cikli II) zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I, duhet të jetë përmbi 7 (shtatë)
2. Mesatarja e Diplomës, duhet të jetë përmbi 8 (tetë)
3. Aktiviteti artistik individual (solistik, muzikë dhome) i kandidatit gjatë periudhës së studimeve në Ciklit I.
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga Komisioni i Vlerësimit ad hoc.

**DEKANI**  
**Prof. Dr. Zana Shuteriqi-Prela**





## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 5. Programet studimit: Master i Arteve në Flaut, Oboe, Klarinetë, Fagot, Korno, Trompë, Trombon

Konkursi për studimet e Ciklit II në Programet e interpretimit Master i Arteve në programet Flaut, Oboe, Klarinetë, Fagot, Korno, Trompë, Trombon (Cikli II) zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I, duhet të jetë përmbi 7 (shtatë)
2. Mesatarja e Diplomës, duhet të jetë përmbi 8 (tetë)
3. Aktiviteti artistik individual (solistik, muzikë dhome) i kandidatit gjatë periudhës së studimeve në Ciklit I.
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga Komisioni i Vlerësimit ad hoc.

**DEKANI**

**Prof. Dr. Zana Shuteriqi Prela**





## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimi në programet e studimit të Ciklit II në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 5. Programet e studimit: Master Profesional në Bastubë, Fisarmonikë Klasike dhe Kitarë

Konkursi për studimet e Ciklit II në Programet e studimit Master Profesional në Bastubë, Fisarmonikë

Klasike dhe Kitarë (Cikli II) zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I, preferohet të jetë përmbi 7 (shtatë)
2. Mesatarja diplomës, preferohet të jetë përmbi 8 (tetë)
3. Aktiviteti artistik individual i kandidatit (solistik, muzikë dhome) gjatë periudhës së studimeve të Ciklit I
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga Komisioni i Vlerësimit ad hoc.

**DEKANI**

**Prof. Dr. Zana Shuteriqi Prela**







Tiranë, më    /    /    2016

## RREGULLORE

# PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË "BACHELOR" NË FAKULTETIN E MUZIKËS, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE PËR VITIN AKADEMIK 2016 – 2017

MIRATUAR ME VENDIM NR   11  , DATË   15.02.2016  

TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE



Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ( i ndryshuar ), Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 74 Pranimi në ciklin e parë të studimeve, konkurset e pranimit në Fakultetin e Muzikës për vitin akademik 2016-2017 do të zhvillohen si më poshtë:

### Neni 1

#### Pranimi i kandidatëve

- 1.1 Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Arteve, bëhen mbi rezultatin e konkurseve që zhvillohen pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit sipas kësaj Rregulloreje si dhe kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve dhe pikëve totale të Maturës Shtetërore.
- 1.2 Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta Për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3 Përzgjedhja e tyre është e ndërvarur nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, posaçërisht për trojet Shqiptare.
- 1.4 Pikët e vlerësimit për çdo konkurrent do të ndahen sipas Udhëzimeve të MAS.

### Neni 2

#### Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

- 2.1 Dekani i Fakultetit, mbështetur nga propozimet e Përgjegjësve të Njësive Bazë, merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Pranimit për çdo program e Studimi.
- 2.2 Përbërja e Komisionit të Pranimit të Programit të Studimit shpallet në ditën e fillimit të konkursit.
- 2.3 Në përbërjen të Komisionit të Pranimit aktivizohen:
  - I. Titullarë të fushës përkatëse,
  - II. Pedagogë efektivë të Departamenteve përkatëse,
  - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës për ato programe studimi ku nuk mund të mbulohen nga pikat I, II të këtij Neni.
- 2.4 Në përbërjen të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë bërë konsultime private lidhur me konkursin e pranimit apo janë në konflikt interesi.
- 2.5 Në ambientet ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga Titullari i Fakultetit të Muzikës .
- 2.6 Për monitorimin e të gjithë procedurave të konkurrimit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, Rektori i UART, me Urdhër të



posaçëm ngre grupin përkatës, i cili monitoron cilësinë e zhvillimit të gjithë procedurave të konkurrimit në Fakultetin e Muzikës, si dhe nga përfaqësuesit e MAS.

### Neni 3

#### Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurrimit.

- 3.1 Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- 3.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Muzikës.
- 3.3 Konkursi për Fakultetin e Muzikës do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit, sipas udhëzimeve të MAS.
- 3.4 Lejohen të hyjnë në konkurs vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurrim, të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi si më poshtë:
  - I. *Kartë Identiteti,*
  - II. *Pasaportë për jashtë shteti.*
  - III. *Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente identifikimi nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.*
- 3.5 Kandidati konkurrent për të hyrë në konkurs duhet të paraqesë në hyrje edhe mandat pagesën e bërë në llogari të Universitetit të Arteve. Kjo e bazuar në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- 3.6 Në varësi të specifikave për secilin Program Studimi komisionet do të punojnë paradite dhe pasdite me paraqitjet individuale të kandidatëve, duke i bërë të ditura më parë oraret përkatëse. Oraret duhet të shpallen në ambientet e Fakultetit të Muzikës
- 3.7 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe ambientet e zhvillimit të tyre do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve në ambientet e Fakultetit të Muzikës. Ky kalendar shpallet në Fakultet një javë përpara fillimit të konkursit.
- 3.8 Ditën e parë të konkursit pasi të jenë sistemuar në ambientet e zhvillimit të tij, kandidatëve u komunikohen rregullat e konkurrimit. Kjo bëhet nga Kryetarët e komisioneve përkatëse.
- 3.9 Sekretaria mësimore ju dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të Programit të Studimit të gjitha materialet për konkurs, si dhe listat e konkurrentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 3.10 Bazuar në kriteret për secilin Program Studimi, komisionet krijojnë hapësirën kohore të nevojshme për shpërfaqjen individuale të kandidatëve gjatë konkurrimit.



#### Neni 4

##### Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

- 4.1 Vlerësimi për paraqitjen individuale të çdo kandidati bëhen nga Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohen nga titullari i Fakultetit.
- 4.2 Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre).
- 4.3 Gjatë paraqitjes individuale të kandidatëve, anëtarët e jurisë mbajnë shënimet përkatëse. Po ashtu çdo anëtar i jurisë ka të drejtë t'i drejtojë kandidatin që konkurren kërkesa konkrete, të cilat i duken të arsyeshme për një shpërfaqje sa më të mirë të tij.
- 4.4 Mbas paraqitjes së kandidatit të fundit, në mbarim të gjithë seancave që parashikohen në kriteret e konkurrimit, Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, nën drejtimin e Kryetarit, mblidhen për të vlerësuar një për një paraqitjet e secilit kandidat. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 4.5 Pikët e mundshme në dispozicion të Komisionit të pranimit, shpërndahen në mënyrë të barabartë tek të gjithë anëtarët e komisionit. Secili anëtar vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatit.
- 4.6 Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët respektive në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista në fund nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit.
- 4.7 Lista e nënshkruar si dhe shënimet e anëtarëve të komisionit të pranimit për çdo konkurrent, i dorëzohen me procesverbal titullarit të Fakultetit.
- 4.8 Komisionet e Programeve të Studimit në Fakultetin e Muzikës, me kërkesë të tyre, mund të kërkojnë Titullarit të Fakultetit, Xhirimin ose Incizimin e konkursit.
- 4.9 Komisionet e Pranimit të Programit të Studimit pas vlerësimeve për çdo kandidat, të gjitha dosjet dhe kasetat me materialet e mësipërme ja dorëzojnë me procesverbal Titullarit të Fakultetit.
- 4.10 Lista përfundimtare me pikët respektive për të gjithë Programet e Studimit firmosen nga Titullari i Fakultetit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

#### Neni 5

##### Shpallja e fituesve

- 5.1 Shpalljen e listës së renditjes provizore të rezultateve për konkursin e pranimeve të pikëve e bën Dekani i Fakultetit.
- 5.2 Në rastin kur disa konkurreues kanë fituar të njëjtin numër pikësh, ata nënrenditen midis tyre sipas rendit zbritës të pikëve të fituara në testin special.

#### Neni 6

##### Regjistrimi për të fituar statusin e studentit

- 6.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të regjistrohen për të fituar statusin e studentit.



- 6.2 Kandidatët që regjistrohen si student në Universitetin e Arteve duhet të paraqitin **dokumente origjinale**. Ato duhet të jenë në vartësi të Udhëzimeve të MAS.
- 6.3 Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet: numri i regjistrimit, emri i kandidatit si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 6.4 Gjithashtu në këtë regjistër duhet të nënshkruajë çdo kandidat fitues, i regjistruar më parë, por që kërkon të ç'regjistrohet nga kjo degë për arsye të ndryshme.
- 6.5 Kandidatit që ç'regjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale por jo pagesa e regjistrimit.
- 6.6 Regjistrimet e kandidatëve fitues për të gjitha kuotat kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Muzikës, në datat që do të përcaktojë Ministria e Arsimit dhe Sportit.

#### Neni 7

#### Rregulla për kandidatët

Gjatë konkursit, kandidati duhet të respektojë këto rregulla:

- 7.1 Kandidatët duhet të paraqiten në Fakultet ditën e parë të fillimit të konkursit në orën e përcaktuar në kalendarin e zhvillimit të konkurseve i shpallur në Fakultetin e Muzikës.
- 7.2 Kandidati do të paraqitet para Komisionit të Pranimi të Programit të Studimit në bazë të orarit që do të përcaktojë Komisioni i Programit të Studimit. Mosparaqitja në bazë të këtij orari çon në s'kualifikimin e tij nga konkursi.
- 7.3 Konkursi është kolektiv dhe individual.
- 7.4 Kandidati duhet të shpërfaqë para Komisionit kërkesat që rrjedhin nga kriteret për çdo Program Studimi.
- 7.5 Nga ana tjetër komisioni krijon atmosferën e nevojshme që kandidati të shpreh aftësitë e tij.
- 7.6 Kandidati do të largohet nga konkurrimi vetëm kur komisioni t'ia kërkojë këtë gjë.

DEKANE

Prof. Dr. Zana Shuteriqi (Prela)





Nr. Prot. <sup>25</sup>...

Tiranë, më 03. 2. 2016

## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit I në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 1. Programi mësimor: MUZIKOLOGJI

#### A. Dispozita të përgjithëshme

1. Konkursi për programin e muzikologjisë zhvillohet në dy faza.

#### B. FAZA E PARË

1. Kjo fazë përfshin provat me shkrim në disiplinat Sofezh dhe Harmoni.
2. Vlerësimi maksimal i mundshëm për secilën nga provat është 30 pikë (gjithsej  $30 \times 2 = 60$  pikë).
3. Kohëzgjatja për secilën prej provave të mësipërme është 1 orë e 30 minuta për secilin.
4. Të gjitha provat e mbështeten mbi kërkesat e programeve teorike të shkollën e mesme.
5. Testet e solfezhit dhe harmonisë hartohen sipas grup-programit përkatës

#### B.1. Prova e solfezhit:

B.1.1. Diktat ritmik në metër dypjestues dhe trepjestues (metër i thjeshtë dhe i përbërë) me figura që përmbajnë edhe përdorimin e pushimeve dhe lidhjeve përkatëse brenda kufirit të vlerës gjashtëmbëdhjetëshe.

B.1.2. Diktat melodik me një zë në kufinj të harmonisë tonale, pasuruar me shmangie dhe modulacione të gradës së parë dhe të dytë.



B.1.3. Diktat melodik me dy zëra me një nivel mesatar vështirësie, brenda kufinjve të harmonisë tonale dhe me modulacione të gradit të parë

B.1.4. Identifikim përmes dëgjimit të kuintakordeve e septakordeve dhe përmbysjeve të tyre.

## B.2. Prova e harmonisë

1. Prova e Harmonisë përmban dy ushtrime me shkrim si më poshtë:

- harmonizim i një melodije të dhënë
- harmonizim i një basi të dhënë

2. Përcaktimi i pikëve për secilën provë të veçantë kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimi

## C. FAZA E DYTË

1. Të gjitha kërkesat e konkursit të parashtruara në fazat I dhe II mbështeten në të dhënat e programeve teorike të shkollave të mesme profesionale.

2. Të gjitha provat e kësaj faze lidhen drejtpërsëdrejti me kërkesat e programit mësimor të Muzikologjisë.

3. Vlerësimi maksimal për provat e fazes së dytë është 180 pikë.

4. Përcaktimi i pikëve për secilën provë të veçantë kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimi

**C.1.** Analizë muzikore me shkrim e Preludi për piano nga F. Chopin, të përzgjedhur me tezë prej listës së mëposhtme:

1. Frederic Chopin: Preludi Nr. 4
2. Frederic Chopin: Preludi Nr. 6
3. Frederic Chopin: Preludi Nr. 15
4. Frederic Chopin: Preludi Nr. 17

## C.2. Lojë në instrument

Konkurenti duhet të luajë në një instrument (mundësisht në piano), një vepër të përmasave dhe të nivelit mesatar të vështirësisë.



**C.3. Test formues në disiplinat teorike të muzikës:** Histori muzike, Analizë forme, Folklor Muzikor, Teori elementare e muzikës dhe Harmoni<sup>1</sup>. Testi përfshin 30 pyetje me nga tre mundësi përgjigjeje sipas modelit të mëposhtëm:

<b>F. Chopin është kompozitor:</b>			<b>Klasicizmi muzikor i përket:</b>		
	Po	Jo		Po	Jo
a. klasik	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	a. shekullit VII	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. romantik	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	b. shekullit XVIII	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. impresionist	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	c. shekullit XIX	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**C.4. Intervistë e komisionit me secilin konkurent mbi intersat dhe formin artistik**

**Shënim:** Mosplotësimi qoftë edhe i një prej detyrimeve të fazës së dytë e përjashton vetvetiu konkurrentin nga konkursi.

**DEKANI**  
**Prof. Dr. Zana Shuteriqi (Prela)**







## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimi në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 2. Programi mësimor: PEDAGOGJI MUZIKORE

#### A. Dispozita të përgjithëshme

1. Konkursi për programin e pedagogjisë muzikore zhvillohet në dy faza.

#### B. FAZA E PARË

1. Kjo fazë përfshin provim me shkrim në disiplinat Sofezh dhe Harmoni.
2. Vlerësimi maksimal i mundshëm për secilën nga provat është 30 pikë (gjithsej  $30 \times 2 = 60$  pikë).
3. Kohëzgjatja për secilën prej provave të mësipërme është 1 orë e 30 minuta për secilin.
4. Të gjitha provat e mbështeten mbi kërkesat e programeve teorike të shkollën e mesme.
5. Testet e solfezhit dhe harmonisë hartohen sipas grup-programit përkatës

#### B.1. Prova e solfezhit:

B.1.1. Diktat ritmik në metër dypjestues dhe trepjestues (metër i thjeshtë dhe i përbërë) me figura që përmbajnë edhe përdorimin e pushimeve dhe lidhjeve përkatëse brenda kufirit të vlerës gjashtëmbëdhjetëshe.

B.1.2. Diktat melodik me një zë në kufinj të harmonisë tonale, pasuruar me shmangie dhe modulacione të gradës së parë dhe të dytë.

B.1.3. Diktat melodik me dy zëra me një nivel mesatar vështirësie, brenda kufinjve të harmonisë tonale dhe me modulacione të gradit të parë

B.1.4. Identifikim përmes dëgjimit të kuintakordeve e septakordeve dhe përmbysjeve të tyre.



## B.2. Prova e harmonisë

1. Prova e Harmonisë përmban dy ushtrime me shkrim si më poshtë:
  - harmonizim i një melodije të dhënë
  - harmonizim i një basi të dhënë
2. Përcaktimi i pikëve për secilën provë të veçantë kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit

## C. FAZA E DYTË

1. Të gjitha kërkesat e konkursit të parashtruara në Fazën II mbështeten në të dhënat e programeve të shkollave të mesme profesionale.
2. Të gjitha provat e kësaj faze lidhen drejtpërdrejt me kërkesat e specialitetit Pedagogji Muzikore.
3. Vlerësimi maksimal për provat e Fazës së dytë është 180 pikë.
4. Përcaktimi i pikëve për secilën provë të veçantë kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit
5. Mosplotësimi qoftë edhe i një prej detyrimeve të fazës së dytë e përjashton automatikisht konkurrentin nga konkursi.

### C.1 Lojë në instrument

1. Konkurenti duhet të luajë në një instrument një vepër të përmasave dhe të nivelit mesatar të vështirësisë.
2. Vlerësimi maksimal për këtë provë është 60 pikë

**C.2 Test i përgjithshëm formues, artistik e kulturor:** Histori muzike, Analizë forme, Folklor, Teori elementare e muzikës, Harmoni, Letërsi shqiptare dhe botërore, Histori e përgjithshme, Kulturë gjuhësore. Testi përfshin 40 pyetje me nga tre mundësi përgjigjeje sipas modelit të mëposhtëm:



**Autori i Operës Mrika është:**

- |              | Po                       | Jo                       |
|--------------|--------------------------|--------------------------|
| a. M. Gjoka  | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| b. K. Kono   | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| c. P. Jakova | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

**J. S. Bah është kompozitor i periudhës së:**

- |                | Po                       | Jo                       |
|----------------|--------------------------|--------------------------|
| a. Rilindjes   | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| b. Barokut     | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| c. Klasicizmit | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

1. Vlerësimi maksimal për këtë provë është 180 pikë

**DEKANI**

**Prof. Dr. Zana Shuteriqi (Prela)**





## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimi në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 3. Programi mësimor: KOMPOZIM

#### A. Dispozita të përgjithëshme

1. Konkursi për programin e kompozimit zhvillohet në dy faza.
2. Për specialitetin e kompozicionit parapëlqehen kandidatët të cilët e kanë mbaruar shkollën e mesme për piano, violinë ose violonçel.

#### B. FAZA E PARË

1. Kjo fazë përfshin provim me shkrim në disiplinat Sofezh dhe Harmoni.
2. Vlerësimi maksimal i mundshëm për secilën nga provat është 30 pikë (gjithsej  $30 \times 2 = 60$  pikë).
3. Përcaktimi i pikëve për secilën provë të veçantë kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimi
4. Kohëzgjatja për secilën prej provave të mësipërme është 1 orë e 30 minuta për secilin.
5. Të gjitha provat mbështeten mbi kërkesat e programeve teorike të shkollës së mesme.
6. Testet e solfezhit dhe harmonisë hartohen sipas grup-programit përkatës.

#### B.1. Prova e solfezhit:

B.1.1. Diktat ritmik në metër dypjestues dhe trepjestues (metër i thjeshtë dhe i përbërë) me figura që përmbajnë edhe përdorimin e pushimeve dhe lidhjeve përkatëse brenda kufirit të vlerës gjashtëmbëdhjetëshe.



B.1.2. Diktat melodik me një zë në kufinj të harmonisë tonale, pasuruar me shmangie dhe modulacione të gradës së parë dhe të dytë.

B.1.3. Diktat melodik me dy zëra me një nivel mesatar vështirësie, brenda kufinjve të harmonisë tonale dhe me modulacione të gradit të parë

B.1.4. Identifikim përmes dëgjimit të kuintakordeve e septakordeve dhe përmbysjeve të tyre.

## B.2. Prova e harmonisë

1. Prova e Harmonisë përmban dy ushtrime me shkrim si më poshtë:

- harmonizim i një melodije të dhënë

- harmonizim i një basi të dhënë

2. Përcaktimi i pikëve për secilën provë të veçantë kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit

## C. FAZA E DYTË

1. Të gjitha provat e kësaj faze lidhen drejtpërsëdrejti me kërkesat e programit mësimor të Kompozimit muzikor. Vlerësimi maksimal për këtë fazë është 180 pikë.

2. Përcaktimi i pikëve për secilën provë të veçantë kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit

3. Mosp<sup>1</sup>lotësimi qoftë edhe i njërit prej detyrimeve të fazës së dytë e skualifikon automatikisht konkurrentin nga konkursi.

### C.1 Provat speciale

#### C.1.1. Punime të kompozuara më parë

Kandidati për specialitetin e kompozicionit duhet të sjellë me vete 4 krijime të tij të specifikuara në gjinitë si më poshtë:

C.1.1.1. Këngë popullore të punuar për kor, ose për solist e piano etj.

C.1.1.2. Romancë e thjeshtë për vokal e piano

<sup>1</sup> Konkurenti është i detyruar të sjellë nga një punë në secilën nga rubrikat e përcaktuara (C.1.1.1, C.1.1.2 dhe C.1.2.3); puna e katërt mund të realizohet sipas dëshirës në njërin prej katër rubrikave.



C.1.2.3. Pjesë të gjinive të ndryshme për instrument piano, violinë e piano, ansambël instrumental etj.

#### C.1.2. Detyrë në klasë

C.1.2.1. Të krijojë një pjesë instrumentale deri në formën tripjesore me temë të dhënë nga komisioni (pjesa mund të shkruhet për piano dhe ansambël, sipas dëshirës së kandidatit) koha 3 orë.

C.1.2.2. Të improvizojë në instrument (mundësisht në piano) mbi një motiv të dhënë.

#### C.2 Harmoni

C.2.1. Të luajë në piano një skemë harmonike të dhënë

C.2.2. Të kryejë analiza harmonike tonale.

C.2.3. Përcaktimi i pikëve për secilën provë të veçantë kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimi

#### C.4. Intervistë e komisionit me secilin konkurent mbi formimin e përgjithshëm muzikor

**DEKANI**

**Prof. Dr. Zana Shuteriqi (Prela)**





## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në FM

Viti akademik 2016 - 2017

### 4. Programi mësimor: DIRIZHIM

#### A. Dispozita të përgjithëshme

1. Konkursi për programin e dirizhimit zhvillohet në dy faza.
2. Për specialitetin e dirizhimit do të parapëlqehen kandidatët të cilët e kanë mbaruar shkollën e mesme për piano, violinë ose violonçel.

#### B. FAZA E PARË

1. Kjo fazë përfshin provim me shkrim në disiplinat Sofezh dhe Harmoni.
2. Vlerësimi maksimal i mundshëm për secilën nga provat është 30 pikë (gjithsej  $30 \times 2 = 60$  pikë).
3. Kohëzgjatja për secilën prej provave të mësipërme është 1 orë e 30 minuta për secilin.
4. Të gjitha provat e mbështeten mbi kërkesat e programeve teorike të shkollën e mesme.
5. Testet e solfezhit dhe harmonisë hartohen sipas grup-programit përkatës

#### B.1. Prova e solfezhit:

B.1.1. Diktat ritmik në metër dypjestues dhe trepjestues (metër i thjeshtë dhe i përbërë) me figura që përmbajnë edhe përdorimin e pushimeve dhe lidhjeve përkatëse brenda kufirit të vlerës gjashtëmbëdhjetëshe.

B.1.2. Diktat melodik me një zë në kufinj të harmonisë tonale, pasuruar me shmangie dhe modulacione të gradës së parë dhe të dytë.

B.1.3. Diktat melodik me dy zëra me një nivel mesatar vështirësie, brenda kufinjve të harmonisë tonale dhe me modulacione të gradit të parë



B.1.4. Identifikim përmes dëgjimit të kuintakordeve e septakordeve dhe përmbysjeve të tyre.

## B.2. Prova e harmonisë

1. Prova e Harmonisë përmban dy ushtrime me shkrim si më poshtë:

- harmonizim i një melodije të dhënë
- harmonizim i një basi të dhënë

2. Përcaktimi i pikëve për secilën provë të veçantë kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit

## C. FAZA E DYTË

1. Të gjitha provat e kësaj faze lidhen drejtpërsëdrejti me kërkesat e specialitetit Dirizhim.

2. Vlerësimi maksimal për këtë fazë është 180 pikë.

3. Përcaktimi i pikëve për secilën provë të veçantë kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit

**Prova 1:** Kandidati duhet të interpretojë përpara komisionit dy pjesë korale *a cappella* (për kor të një gjinie ose kor të përzierë) nga kompozitorët paraklasikë, klasikë romantikë, ose të shekullit XX, dhe një pjesë shqiptare.

**Prova 2:** Kandidati duhet të ketë përgatitur dy pjesë orkestrale: Minuet, Suitë, Uverturë ose Kohën e parë të një simfonie paraklasike, klasike ose romantike si dhe pjesë nga kompozitorë shqiptarë.

**Prova 3:** Kandidati duhet të dëshmojë njohjen shumë të mirë të partiturës duke luajtur në piano ose duke kënduar linjat melodike të zërave dhe partet e instrumentave të ndryshëm, të njohë epokën kur ka jetuar dhe karakteristikat e krijimtarisë së kompozitorit veprën e të cilit drejton.

**Prova 4:** Kandidati duhet të ketë njohuri të përgjithshme të mira mbi muzikën vokale, muzikën korale, operistike, simfonike dhe instrumentale.

**Prova 5:** Kandidati duhet të luajë në piano një vepër të vështirësisë mesatare nga kompozitorë si Mozart, Beethoven, Haydn etj.





**Prova 6:** Dëgjime nota teke, intervale, A5 A7 me përmbysje

Lexim a prima vista, ushtrim ritmik, ushtrim melodik.

**D. Materialet që rekomandohen:**

**D.1. Vepra korale**

*D.1.1. Vepra korale të periudhës paraklasike*

- |                  |                       |
|------------------|-----------------------|
| P. da Palestrina | - O crux Ave          |
| O. di Lasso      | - Madona ma pieta     |
| A. Gastoldi      | - Questa dolce sirena |
| C. Monteverdi    | - Lasciatemi morire   |

*D.1.2. Vepra korale të periudhës klasike*

- |              |                                      |
|--------------|--------------------------------------|
| W. A. Mozart | - Ave verum corpus                   |
| W. A. Mozart | - Korale nga Mesha "Coronation Mass" |
| J. Haydn     | - Korale të ndryshme                 |

*D.1.3. Vepra korale të periudhës romantike*

- |                 |  |
|-----------------|--|
| R. Schumann     | - Në qetësinë e natës                  |
| F. Schubert     | - Heilig ist der Herr                  |
| P. I. Çajkovski | - Reja e bardhë                        |
| G. Bizet        | - Korale nga opera "Carmen"            |
| G. Verdi        | - Korale nga opera Traviata, Trovatore |

*D.1.4. Vepra korale nga autorë shqiptarë*

- |        |                                 |
|--------|---------------------------------|
| Zadeja | - Shkon djali tërmal            |
| Jakova | - Korale nga opera "Skënderbeu" |



